

REKOMANDIMET

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

Sesioni 2, Tema: Prodhimi dhe standardet për produktet artizanale dhe ushqimore – eksperiencia sllovaqe dhe rastet praktike më të mira (Kapitulli 1)

e premte, 28 tetor 2022, Pogradec

Në Shqipëri politikat për skemat e cilësisë janë pak të njohura në treg si nga grupet e interesit ashtu dhe nga konsumatorët në përgjithësi, por megjithatë ekzistuese dhe të rregulluara me ligjin nr. 8/2019 datë 26.02.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Legjislacioni për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesit gjeografikë dhe specialitetet tradicionale për produktet bujqësore dhe ato ushqimore dhe kontrollin e kësaj mbrojtjeje përfshihen në Kapitullin 11 – Bujqësia dhe Zhvillimi Rural të Acquis të BE-së, por të lidhura ngushtësisht me politikat e Kapitullit 1 - Lëvizja e lirë e mallrave në kuadër të tregtisë, shkëmbimit tregtar si dhe mundësisë për eksport të këtyre produkteve në tregun europian. Ligji nr. 8/2019 krijon skemat e cilësisë në nivel kombëtar, si dhe përcakton mënyrën e aplikimit e regjistrimit, institucionet përgjegjëse për njohjen dhe mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara për produktet bujqësore dhe ato ushqimore. Në zbatim të ligjit nr. 8/2019 janë parashikuar dhe miratuar akte nënligjore plotësuese. Sipas raportit të Komisionit Europian për vitin 2022, legjislacioni për përcaktimin dhe mbrojtjen e cilësisë në Shqipëri rezulton *pjesërisht i harmonizuar* me acquis e BE.

Gjatë prezantimit dhe diskutimit dolën në pah disa rekomandime e sugjerime sesi mund të përmirësohet zbatueshmëria e legjislacionit ekzistues, të përforcohen strukturat administrative dhe rriten përfitimet për sipërmarrësit shqiptarë, bazuar këto në eksperiencën sllovaqe prezantuar nga ekspertja sllovaqe e pranishme në takim, eksperte pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Sllovaki.

Kuadri ligjor dhe institucional kombëtar

- *Për një rregullim dhe organizim të tregut për prodhimtarinë vendase duhet që kuadri ligjor kombëtar të jetë specifik për këto çështje dhe sa më gjithëpërfshirës bazuar në standardet europiane, që ndihmon dhe fuqizon pozitën e prodhuesve.*
- *Rekomandohet përmirësimi dhe përafrimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe plotësimi i kuadrit institucional për skemat e cilësisë në nivel kombëtar me legjislacionin europian duke marrë praktikën më të mira europiane, por duke mbajtur në konsideratë specifikat e Shqipërisë dhe të prodhuesve vendas.*
- *Sugjerohet krijimi i një sistemi elektronik të thjeshtësuar për aplikimin dhe regjistrimin e skemave të cilësisë për lehtësimin e procedurave e aplikimit. Një praktikë e suksesshme e realizuar nga ana e Sllovakisë është kalimi i regjistrimit të skemave të cilësisë në formatin e një faqeje*

interneti, që do të mundësojë jo vetëm përditësimin e lehtësuar të të dhënave, por edhe konsumatorët mund të informohen më shpejtë. Këshillohet që informacioni sa më i thjeshtë dhe i kuptueshëm, por në të njëjtën kohë ezaurues dhe navigimi në këtë faqe të jetë sa më miqësor me përdoruesit.

- Rreziqet për mosrespektimin e kritereve specifike, keqpërdorimi apo dhënia e paverifikuar e certifikatave mund të sjellin dëme për prodhuesit, pasi krijon mosbesim të konsumatorët dhe ul vlerën e produktit real. Ndaj është thelbësore funksionimi plotësisht i institucioneve të pavarura të inspektimit dhe përforcimi i kapaciteteve që të mund të bëhen kontrollat e duhura gjatë fazës së aplikimit dhe më pas, për cilësinë dhe ruajtjen e vlerave dhe parametrave në mënyrë rigoroze.
- Komisionet vlerësuese duhet të jenë sa më profesionale e mbi të gjitha objektive në vlerësimin dhe dhënien e certifikatave dhe të jenë rigoroz në vlerësimin e kritereve që duhet të plotësohen. Anëtarët e këtyre komisioneve mund të trajnohen dhe të marrin eksperiencë nëpërmjet trajnimeve dhe shkëmbimeve me vende të Bashkimit Europian apo edhe të rajonit.
- Një fushatë informimi dhe promovimi duhet të ndërmerret nga institucionet përgjegjëse mbi këto pulla cilësie dhe procesin e aplikimit dhe vlerësimit, si në nivel kombëtar dhe europian. Informacioni i prodhuesve shqiptarë për mundësinë e aplikimit në skemat e cilësisë së BE është shumë i ulët dhe në raste kur ai ekziston është e vështirë për ta të realizojnë aplikimet e duhura dhe të dërgojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Sugjerohet që informacioni të ketë fokus jo vetëm arritjen e standardeve dhe kritereve, por edhe të shpjegojë përfitimet që vijnë nga aplikimi në skema të tilla për mundësitë e eksportit dhe tregtisë në tregun europian dhe më gjerë.
- Një rol me rëndësi duhet të luaj dhe pushteti lokal që janë më afër prodhuesve lokalë dhe kanë informacionin e nevojshëm sa i përket karakteristikave të prodhimeve lokale, nevojave të prodhuesve sidomos atyre artizanalë/tradicionale. Për këtë rekomandohet që pushteti lokal mund të ofrojë mbështetje teknike apo dhe financiare për prodhuesit lokalë duke targetuar grupe si gratë sipërmarrëse, të rinjtë apo bizneset e vogla dhe të reja.

Bashkëpunimi i sektorit privat dhe prodhues me institucionet shtetërore

- Është me rëndësi vendosja e urës së bashkëpunimit dhe realizimi i bisedimeve dhe negociatave me Ministrinë përkatëse për të përcaktuar statusin dhe pozicionin e prodhuesve duke adresuar kërkesat dhe nevojat e tyre që në fazat fillestare sa i përket hartimit dhe përditësimin të kuadrit ligjor për skemat e cilësisë në mënyrë që të merren në konsideratë këto kërkesa.
- Këshillohet që komuniteti i fermerëve dhe sipërmarrësve të jetë aktiv dhe i përfshirë në politikëbërje edhe me iniciativë të tyre, kur shohin se ka nevojë për hartim legjislativ apo përmirësime bazuar në kërkesa dhe nevojat e tyre, (siç ka ndodhur në Sllovaki për legjislativonin e sistemit të markave të cilësisë)
- Rekomandohet që për përcaktimin e indikatorëve gjeografikë kombëtarë duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve vendore, qendrore dhe prodhuesve ku prodhuesit mund të asistojnë

institucionet përgjegjëse për të kuptuar në praktikë proceset prodhuese dhe karakteristikat e veçanta gjeografike, që janë dhe vlera e shtuar për të aplikuar në këto skema.

Organizimi dhe ngritja e kapaciteteve të aktorëve të interesit

- Në mungesë të iniciativës nga autoriteti përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e produkteve vendase, ekspertja këshillon organizimin e prodhuesve dhe aktorëve të tjerë të interesit në nivel lokal apo kombëtar, parashtrimin e një plani të qartë veprimi, ku të përfshihen kërkesat dhe pritshmëritë dhe mënyra se si mund të realizohen ato.
- Rekomandohet që prodhuesit shqiptarë të aplikojnë për TSG (specialitet tradicional i garantuar), pasi kjo pullë/certifikatë është një mundësi shumë e mirë për Shqipërinë për shkak të historisë së gjatë dhe traditave të prodhimit të produkteve ushqimore dhe artizanale. TSG mund të ndahet edhe me shtete të tjera, një shembull mund të jetë “fli-ja”, një ushqim tradicional që e ndajmë me Kosovën, por edhe reçelrat e ndryshme, apo turshitë dhe prodhime të ndryshme të brumit që janë më karakteristike për zonën e Pogradecit.
- Rekomandohet që fermerët dhe prodhuesit së bashku me palë të tjera të interesuara të organizohen seriozisht në grup/shoqata dhe të aplikojnë për certifikatat e cilësisë pranë BE-së, në mënyrë që aplikimi të plotësohet saktë dhe me **detaje specifike në përshkrimin e produktit**. Detajet specifike janë shumë të rëndësishme dhe mund të bëjnë ndryshimin në marrjen e pullës.
- Rekomandohet që të aplikohet për këto pulla cilësie pasi janë **tregues të vlerës së shtuar të cilësisë** për prodhimet vendase. Kjo ndikon në rritjen e vlerës së produkteve në treg, në lehtësimin e lëvizjes dhe tregtimin e tyre në tregje ndërkombëtare duke rritur eksportin dhe promovimin e produkteve vendase. Historia e suksesit për fermerët portugezë që dardha “Rocha e Oeste-s”, vendase e një rajoni të vogël të veçantë Oeste, në veri të Lisbonës, e cila mban statusin e origjinës së mbrojtur (PDO). **Shoqata e Kultivuesve të Dardhës Rocha** (Associação Nacional de Produtores de Pêra Rocha) bashkon subjektet kryesore të përfshira në këtë sektor: fruta-prodhuesit, shoqatat e frutave, shitësit me shumicë të frutave, eksportuesit dhe palët e tjera të interesuara në zhvillimin e Pera Rocha. Falë promovimit të Shoqatës, kjo dardhë tani është kampionja portugeze e frutave përse i përket eksporteve (rreth 60% e prodhimit shkon në më shumë se dhjetë tregje të huaja).
- Organizimi si rajon për krijimin e një strategjie veprimi dhe promovimin e produkteve vendase është thelbësore për ecurinë e tyre në tregun vendas dhe më tej.

PJESËMARRËSIT

Ekspertja sllovae: Viera Baričičová, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sllovaki

Ekspertja kombëtare: Manjola Kamolli, Nënkryetare e Këshillit Bashkiak Pogradec

Bashkë-kryesuese të GP: Flutura Xhabija, Presidente SHGPAZ dhe **Nirvana Deliu**,
Koordinatorë Projektësh, Lëvizja Europiane në Shqipëri

Institucionet shtetërore

Bashkia Pogradec – Zisi Cobani, Nuri Vesho, Eni Pilinci

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Pogradec – Nada Argjiri, specialiste

Sektori privat dhe sipërmarrëse të prodhimeve artizanale - Bajame Topalli, Drita Softa, Mesude Feci, Mukades Rusi

Shoqëria civile dhe universitete

SHGPAZ – Vjoleta Bufi, Filloreta Miti, Anila Bebri,

Shoqata Gruaja Intelektuale Pogradec – Shpresa Blaceri, Dhurata Leka

Lëvizja Europiane në Shqipëri – Erina Troka

Nehemiah Gateway University – Dorian Lek, Dekan

Ekspert i Bujqësisë – Hasan Mani

Tjetër – Zhuljeta Pepo, Mirela Leka,